REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY
PRANUAR 09/12/ 20_25
Nj. Org. | Numër | Shtojca | Vlera
01- | 052/01-52084 |

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Gllogocit/Drenasit
Zyra e Kryetarit

Raport për zbatimin e Planit të Integritetit për Komunën e Drenasit për 6 mujorin e dytë të vitit 2025

Për: z. Burim Sadiku – Udhëheqës i Divizionit për Integritet dhe Strategji,

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit

Cc: z. Ramiz Lladrovci – Kryetar i Komunës së Drenasit

Nga: z. Besart Bajrami – Zyrtar përgjegjës për menaxhimin e përgatitjes dhe zbatimin e Planit të Integritetit

Dhjetor 2025

Raport i zbatimit të Planit Komunal për Integritet 2024-2026

Duke u bazuar në nenin 25 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë e Parandalimit të Korrupsionit, obligohen të gjitha organet e administratës qëndrore dhe agjencitë e pavarura, si dhe autoritetet komunale që të miratojnë planet e tyre të integritetit.

Plani i integritetit është një dokument strategjik dhe operativ që hartohet nga institucionet për një periudhë kohore tre (3) vjeçare, i cili identifikon rreziqet, analizën dhe vlerësimin e rrezikut dhe përcakton masat sipas rreziqeve të identifikuara për arritjen e objektivave të saj të integritetit dhe për të avancuar performancën e integritetit në kuadër të institucionit.

Me zbatimin Planit të Integritetit, institucionet do të tregojnë përkushtimin e tyre për ngritjen dhe avancimin e integritetit brenda institucioneve të tyre, duke përfshirë realizimin e masave që parandalojnë sjelljet dhe veprimet e mundshme korruptive ose veprime tjera që potencialisht cenojnë integritetin.

Ky raport është hartuar nga zyrtari përgjegjës për menaxhimin e përgatitjes dhe zbatimin e Planit të Integritetit të komunës së Drenasit, i cili është caktuar me vendimin e Kryetarit të Komunës, me 01-Nr.400/01-42427 i datës 29.08.2024.

Në pajtim me nenin 25 Ligjit nr.08/l-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe në përputhje me "Metodologjinë e Planeve të Integritetit" të cilat obligojnë të gjitha institucionet të hartojnë dhe miratojnë planet e integritetit, Komuna e Gllogocit/Drenasit, ka hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit për periudhën 2024 -2026, dhe në bazë të aktiviteteve/masave të të cilit është hartuar ky raport.

Të bashkëngjitur me këtë raport në Excel gjeni tabelën e planit të aktiviteteve të PKI-së, ku sipas udhëzuesit për monitorim e zbatim janë shtuar kolonat: Veprimet e ndërmarra, Niveli i zbatimit, Mjetet e verifikimit, Vështirësitë dhe Rekomandimet.

Data: 08.12.2025

Hartues i raportit:

Besart Bajrami

Raportimi I Zbatimit të Planit të Integritetit, 6-mujorin e dytë të vitit 2025 - Komuna E Drenasit

Fushat e përgjithshme të rrezikut

Nr.	Fusha e Rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masa e Propozuar	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i Realizimit	Veprimet e ndërmarra	Niveli I Zbatimit	Mjetet e verifikimit	Vështirësitë	Rekomandimet
1	Drejtimi dhe menaxhimi	Sistematizimi jo adekuat i vendeve te punës.	Hartimi i rregullores së brendshme për sistematizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës	Sektorët e Burimeve Njerëzore Arsim, Personel dhe Shëndetësi	TM2/2024	Është raportuar në periudhat paraprake				
2		Mos definimi i detyrave të punës sipas kualifikimit dhe pozitave	Hartimi i Rregullores së brendshme për sistematizimin dhe përshkrimin e detyrave të punës	Sektorët e Burimeve Njerëzore Arsim, Personel dhe Shëndetësi	TM3/ 2024	Është raportuar në periudhat paraprake				
3		Mungesa e trajnimeve për stafin menaxherial	Trajnimi i stafit menaxherial për menaxhimin e sektorëve përkatëse	Sektorët e Arsimit, Administratës dhe Shëndetësisë	2024-2026	Pjesëmarrja e zyrtarëve komunal në trajnimin për Prokurim Publik në modulet: Menaxhimi I Kontratës dhe Vlerësimi I Performancës së Kontraktorëve. - Është mbajtur trajnimi me datë 01 dhe 02 Tetor 2025, me temën Teknikat e Hartimti të Akteve Juridike dhe është mbajtur trajnimi me dt.24 dhe 25 Nëntor 2025 për menaxhmin e Kontratave.	Realizuar	Certifikimi i Zyrtarëve me certifikatë për pjesëmarrje. Ftesa përmes emailive zyrtare.		Të rritet numri I zyrtarëve të cilët në vazhdim do të certifikohen për menaxhim.
4		Mungesa e Stafit të mjaftueshëm në sektorin e kulturës	Vendosja e një zyrtari për Kulturë	NjBNj, Drejtoria e DKRS-së	2024	Është raportuar në periudhat paraprake				

5		Mungesa e hapësirës së Arkivit Komunal	Sigurimi i hapësirës adekuate dhe të mjaftueshme për Arkivin Komunal	Drejtoria e DKRS-së	2024-2026	Objekti është siguruar dhe është paisur me inventar modern për Arkiv pritet vetëm bartja e materialit arkivor.	Realizuar	Shfrytëzimi I hapësirave në Objektin e Qendrës Rinore në Drenas		
6	Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve	Mungesa e kritereve te veçanta (unike) për vlerësimin e performancës se nëpunësve civil	Përcaktimi i kritereve të qarta dhe unike me rregullore të brendshme	Drejtoritë dhe Udhëheqësit e Sektorëve	TM4/ 2024	Është raportuar në periudhat paraprake				
7		Vështirësitë ne menaxhimin e kontratave të prokurimit	Përcaktimi i menaxherëve sipas lëmive përkatëse apo trajnimi i menaxherëve ekzistues	Njësia e Burimeve Njerëzore	2024-2026	Pjesëmarrja e zyrtarëve komunal në trajnimin për Prokurim Publik në modulet: Menaxhimi I Kontratës dhe Vlerësimi I Performancës së Kontraktorëve	Realizuar	Trajnim I Mbajtur në Janar 2025, organizaur nga Komisioni Rregullativ I Prokurimit Publik, Zyrtarë të Certifikuar		Të rritet numri i zyrtarëve të cilët në vazhdim do të certifikohen pë menaxhim.
8		Menaxhimi jo efikas i ZGJC-së dhe AMF-ve, në teren (Distanca, mungesa e kontrollimit të vijueshmërisë dhe deponimi i mjeteve financiare)	Rregullimi i sistemit të vijueshmërisë dhe kontrollit financiar	DAP/Sektori i Gjendjes Civile, DBF, DSHMS	TM1 2025	Është e rregulluar sipas sistemit të Monitorimit të vijueshmërisë në Punë (SMVP)	Realizuar			Të mirëmbahet vazhdimisht edhe në rastet kur përkohësisht nuk funksionon të gjinden metoda alternative të monitorimit
9		Mos mirëmbajtja e kamerave në ZGJC në teren (Komoran, Tërstenik, Arllat dhe Abri) dhe vendosja në Dobrashec.	Rregullimi dhe mirëmbajtja e kamerave dhe E-kioskave	DAP/Sektori i Gjendjes Civile	TM2 2024	Është raportuar në periudhat paraprake				
10		Mos mirëmbajtja e E-kioskave në Drenas dhe Komoran	Rregullimi dhe mirëmbajtja e E-kioskave	DAP/Sektori i Gjendjes Civile	TM2 2024	Është raportuar në periudhat paraprake				
11		Mungesa e literaturës në Biblioteka	Sigurimi i Objekteve të favorshme dhe salla të leximit për lexues	Drejtoria e DKRS-së	2024-2025	Është bërë Paisja e Biblotekave me Literaturë 1200 tituj me 2000 Ekzemplar	Realizuar	Është pranuar një numër I konsiderueshëm I titujve nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës		Të bëhen hulumtime për burime të financimit për të rritur fondin e literaturës nëpër biblioteka

12	Planifikimi dhe menaxhimi financiar	Vonesa në përgatitjen e propozim-buxhetit Komunale	Informimi dhe dorëzimi me kohë i të gjitha	Të gjitha drejtoritë dhe programet, Programeve dhe Nënprogrameve	2024-2025	Me pranimin e qarkoreve nga MFPT, ZKF ka nxjerr menjëherë qarkoret e brendshme dhe ua ka përcjellë të gjitha Drejtorive/Zyrave udhëzimet dhe kalendarin për dorëzimin kërkesave dhe deri në aprovim të dokumentit.	Realizuar	Njoftimi me shkrese zyrtare nga ZKF per te gjitha nenprogramet		
13		Ndikimi i vendimmarrjes nga niveli qendror në nivelin lokal në zvogëlimin e efikasitetit ne punët e komunës	Intensifikimi i takimeve për koordinim në vendimmarrje në mes të dy niveleve dhe marrja e masave ligjore.	ZKA DHE ZKF	2024-2026	Është dhënë kontributi dhe vlerësimet tona	Realizuar	Takime në forume, shkresa dhe komunikime elektronike		
14		Mos Planifikimi në detale i planit të shpenzimeve	Takime vetëdijësuese me stafin në hartimin e planit të zotimeve dhe shpenzimit;	Programet dhe nën programet	Çdo fundvit 2024, 2025, 2026	Është raportuar në periudhat paraprake				
15		Vonesa në hartimin e planit të prokurimit	Hartimi me kohë i kërkesave nga programet dhe nën programet, angazhimi i stafit me kohë në hartimin e planit të prokurimit	Programet dhe nën programet	Çdo fundvit 2024, 2025, 2026	Është raportuar në periudhat paraprake				
16		Mos Planifikimi i buxhetit në bazë të dokumenteve të planifikimit, strategjive dhe programeve komunale	Përfshirja në kornizën afatmesme buxhetore dhe koordinimi ne mes te sektorëve	Drejtoritë dhe programet	Çdo fundvit 2024, 2025, 2026	Është raportuar në periudhat paraprake				
17		Mos koordinimi i departamenteve në fusha te caktuara	Formimi i grupeve punuese profesionale në fusha të caktuara	ZKA dhe Drejtorët	2024-2026	Është bërë formimi i grupeve punuese profesionale në fusha të caktuara	Realizuar	Formimi I komisioneve profesionale me antarë të drejtorateve të ndryshmë		

18		Mungesa e Buxhetit për organizimin e aktiviteteve kulturore	Të sigurohet buxhet i mjaftueshëm për aktivitetet kulturore	Drejtoria e DKRS-së	2024	Është raportuar në periudhat paraprake				
19		Mos definimi i qartë i Statusit të OJQ-ve	Formimi i Komisioneve për hartimin e Rregulloreve lokale.	Drejtoria e DKRS-së	2024	Është raportuar në periudhat paraprake				
20	**Informimi dhe mbrojtja e të dhënave**	Mos funksionimi i ueb faqes zyrtare të komunës.	Komunikimi i vazhdueshëm me përgjegjësit e mirëmbajtjes së ueb-faqes zyrtare, përkatësisht MAPL-në dhe ASHI-në.	Zyra e Kryetarit	2024-2026	Është bërë lansimi i webfaqeve të reja dhe komunikimi ndërmjet akterëve është në funksional.	Realizuar	https://gllogoc.rks-gov.net/		
21		Pamundësia e publikimeve me kohë të dokumenteve që lidhen me afatet kohore.	Komunikimi i vazhdueshëm me përgjegjësit e mirëmbajtjes së ueb-faqes zyrtare, përkatësisht MAPL-në dhe ASHI-në.	Zyra e Kryetarit	2024-2026	Është bërë lansimi i webfaqeve të reja dhe komunikimi ndërmjet akterëve është në funksional.	Realizuar	Komunikimi i vazhdueshëm me përgjegjësit e mirëmbajtjes së ueb-faqes zyrtare		
22		Mungesë e sigurisë së të dhënave, duke përfshirë humbjen e të dhënave.	Rritja e sigurisë së të dhënave nëpërmjet avancimit të sistemit të sigurisë dhe rritjes se kapaciteteve arkivuese të këtij sistemi.	Zyra e Kryetarit	2024	Është raportuar në periudhat paraprake				
23		Mungesa e trajnimeve të veçanta se si të punohet me të dhënat personale dhe të mbrohen të dhënat personale.	Të sigurohet që personeli marrin trajnim te veçantë për atë se si të punohet me të dhënat personale dhe të mbrohen të dhënat personale.	Zyra e Kryetarit	2024	Është raportuar në periudhat paraprake				

Fushat e veçanta të rrezikut										
24	Auditimi i Brendshëm	Mungesa e Planit Strategjik dhe Planit Vjetor të auditimit të bazuar në rrezik dhe auditimeve rast pas rasti	Para se të hartohet Plani Strategjik dhe Plani Vjetor duhet që të kryhet një Rivlerësim i rregullt vjetor i rrezikut në mënyrë që këto plane të jenë tërësisht të bazuara në rrezik. Të sigurohen auditime rast pas rasti për të vërtetuar të gjeturat gjatë kontrolleve	Njësia e Auditimit (hartimi i planeve). Kryetari i Komunës (miratim), dhe Komiteti i Auditimit (miratim).	2024-2026	Njësia e Auditimit të Brendshëm ka hartuar Planin strategjik të bazuar në rrezik për vitet 2025-2027 dhe të njëjtin e ka aprovuar nga ana e Kryetarit të Komunës dhe Komitetit të Auditimit të Brendshëm me dt.30.12.2024 me nr. protokoli 01.030/01-61730.Njësia e Auditimit të Brendshëm ka hartuar Planin vjetor të angazhimit të kapaciteteve audituese për vitin 2025 dhe ka aprovuar ate nga ana e Kryetarit të Komunës dhe nga Komiteti i Auditimit të Brendshëm me dt. 30.12.2024, me nr.protokoli 01-030/01-61726	I zbatuar	Plani Strategjik per vitet 2025-2027 I dt. 30.12.2024 me nr 01-030/01-61730, Plani vjetor I punes per vitin 2025 I dt. 30.12.2024 me nr. 01-030/01-61726		Te vazhdohet me pune
25		Pamjaftueshmëria e burimeve humane dhe financiare të komunës	Auditimi në personel dhe në buxhet.	Njësia e Auditimit të Brendshëm	2024-2026	Njësia e Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2025 eshte ne perfundim te Raportit te Auditimit te shpenzimit te buxhetit per vitin 2025 dhe për momentin jemi më fazen e ekzaminimit të mostrave. Ky auditim ka filluar me dt. 22.10.2025 me kerkesen per takimin fillestar me nr. 01-400/01-46267	I zbatuar	Kerkesa per Takimin fillestar e dt. 22.10.2025 me nr. 01-400/01-46267		Te vazhdohet me pune
26		Pamundësia e kryerjes së të gjitha auditimeve të parapara sipas Planit Vjetor të Punës.	Rritje e resurseve njerëzore, se paku edhe një auditor.	Kryetari i Komunës	2025	Me Planin Strategjik për vitet 2025-2027, si dhe me Planin vjetor për zhvillimin e aktiviteteve audituese për vitin 2025 është kërkuar shtimi i resurseve humane në fushen e auditimit, si dhe kjo do të bëhet në mënyrë te vazhdueshme derisa kapacitetet humane të plotësohen në tërësi.	I ZBATUAR	Plani Strategjik per vitet 2025-2027 I dt. 30.12.2024 me nr 01-030/01-61730,		Te vazhdohet me pune

27		Vlerësimi jo i drejtë i rrezikut në fusha të caktuara	Njësia e Auditimit të Brendshëm në fund të çdo viti do të kryej një rivlerësim të rregullt vjetor të rrezikut duke marrë parasysh të gjitha ndryshimet që kanë ngjarë në ndryshimin e kompetencave të komunës, ndryshimin e strukturës, dhe ndryshimin e prioriteteve.	Njësia e Auditimit të Brendshëm, Të gjitha drejtoritë	2024-2026	Njësia e Auditimit të brendshëm në fund të vitit 2024 ka kryer Vlerësimin vjetor të rrezikut dhe në bazë të këtij vlerësimi ka bërë planifikimin strategjik dhe ate vjetor. Tani jemi në fazen e rivlerësimit të rregullt vjetor të rrezikut për të hartuar Planin strategjik për vitet 2026-2028, si dhe Planin vjetor për vitin e ardhshëm 2026	I ZBATUAR	Jemi ne ditet e vleresimit te rreziqeve per vitin 2026		Te vazhdohet me pune
28		Mos implementimi i rekomandimeve nga ana e menaxhmentit	Njësia e Auditimit të Brendshëm në baza të rregullta tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore do të raportoj para Komitetit të Auditimit të Brendshëm në lidhje me gjendjen e rekomandimeve të dhëna.	Komiteti i Auditimit të Brendshëm, Kryetari i Komunës, Njësia e Auditimit të Brendshëm, Të gjitha drejtoritë.	2024-2026	Njësia e Auditimit të Brendshëm ka bërë raportimin mbi gjendjen e implementimit të rekomandimeve të dhëna gjatë vitit 2025 dhe ka raportuar para Komitetit të Auditimit të Brendshëm me dt. 09.07.2025	I ZBATUAR	Raportin nr. 01-052/01-24337 I dt. 30.06.2025. Tani jemi në pregaditje të Raportimit vjetor deri me dt. 31.12.2025.		Te vazhdohet me pune
29		Mosdefinimi i qartë i Universit të Auditimit	Definimi i qartë i Universit të Auditimit me Planin Strategjik duke përfshirë të gjitha programet, aktivitetet dhe sistemet që ekzistojnë në komunë.	Njësia e Auditimit të Brendshëm	2024-2026	Me Planin strategjik i cili azhurohet për çdo vit , bëhet edhe përcaktimi i Universit të auditimit i cili nga viti në vit nuk është se ka ndryshime të dukshme me që struktura dhe kompetencat e komunave nuk ndryshojnë shumë shpesh. Për vitin 2025 sipas Universit të auditimit për komunën tonë kemi 26 sisteme të auditimit që e bëjnë Universin e auditimit.	I ZBATUAR	Plani Strategjik per vitet 2025-2027 I dt. 30.12.2024 me nr 01-030/01-61730,		Te vazhdohet me pune

30		Rënia e integritetit dhe qëndrueshmërisë së të dhënave të publikuara në Pasqyrat Financiare.	Auditime të shpeshta në lëminë e shpenzimeve të buxhetit	Njësia e Auditimit të Brendshëm	2024-2026	Sipas Planit vjetor të punës gjithëhere parashifen të kryhen auditime të cilat e rrisin shkallën e integritetit të pasqyrave vjetore financiare të komunës duke kryer auditime në fushen e të hyrave nga Leshuarja e Lejeve ndertimore, inkasimi i Qerase, THV nga Tatimi ne Prone dhe në fushen e shpenzimeve.	I ZBATUAR	Raportet e auditimit nr.01-052/01-18637 I dt. 21.05.2025, Raporti I Auditimit nr. 01-052/01-21837 I dt.12.06.2025 si dhe ne perfundim Raporti I Auditimit per Shpenzimin e buxhetit.		Te vazhdohet me pune
31		Mungesa e mbikëqyrjes së implementimit të rekomandimeve	Raportimi mbi gjendjen e rekomandimeve të dhëna nga ana e auditimit të brendshëm dhe atij të jashtëm. Zhvillimi i një Plani të Veprimit për zbatimin e rekomandimeve.Raportimin e rregullt mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimit	Komiteti i Auditimit, Kryetari i Komunës, Njësia e Auditimit të Brendshëm. Drejtorët e Drejtorateve	2024-2026	Pas çdo auditimi, kërkohet Plani i implementimit nga ana e menaxhmentit dhe mandej me kontrolla të herëpashershme konstatohet implementimi apo mosimplementimi dhe vonesat në implementim. Këto të dhëna i raportohen Kryetarit të Komunës dhe Komitetit të Auditimit të Brendshëm i cili edhe nxjerr konkluzione mbi veprimet që duhet ndërmarrur për shtimin e implementimit të rekomandimeve.	I ZBATUAR	Raporti I implementimit te rekomandimeve me dt. 30.12.2024 nr.01-052/01-61737, dhe Raporti I implementimit te rekomandimeve me dt. 30.06.2025 nr.01-052/01-24326		Te vazhdohet me pune
32		Mungesa e koordinimit ndërmjet Njësisë së AB, Komitetit të Auditimit, Kryetarit dhe drejtorëve të drejtorive.	Të përmirësohet sistemi i komunikimit mes njësisë së auditimit të brendshëm dhe organeve të tjera komunale. Vështirësi ne komunikim kohe pas kohe mund te këtë me drejtorët e drejtorive komunale.	Kryetari i Komunës, Komiteti i Auditimit, Njësia e AB, Komiteti i Auditimit dhe Drejtorët e Drejtorive.	2024-2026	Gjatë të gjitha mbledhjeve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm kanë marrur pjesë të gjith menaxherët e drejtorateve të cilat janë audituar dhe që Raporti i tyre i auditimit është shqyrtuar në atë mbledhje. Poashtu edhe Kryetari i Komunës në mënyrë të vazhdueshme merr pjesë në këto mbledhje dhe kështu krijohet mundësia e një bashkëpunimi më të mirë në mes të audituarve, Njësisë së Auditimit të Brendshëm, Komitetit të Auditimit dhe Menaxhmentit më të lartë të Komunës.	I ZBATUAR	Mbledhjet e Komitetit te Auditimit te Brendshem te mbajtura me proqesverbalet me dt. 14.01.2025 nr.01-400/01-2882 , me dt. 10.04.2025 nr. 01-400/01-13656, me dt. 09.07.2025 nr. 01-060/01-26755, dhe me dt. 09.10.2025 nr. 400/01-44737		Te vazhdohet me pune

33		Mospërshtatja e qasjes së auditimit	Të aplikohen tri qasjet e auditimit që janë të parapara edhe në Planin Strategjik duke përfshirë Qasjen funksionale, strukturore dhe qasjen e kombinuar.	Njësia e Auditimit të Brendshëm	2024-2026	Njësia e Auditimit të Brendshëm nga tri mundësitë që ka për të zgjedhur qasjen e auditimit (qasja funkcionale, qasja strukturale, dhe qasja e kombinuar) në çdo auditim ka zgjedhur qasjen e kombinuar për arësye se është qasje që siguron një pasqyrë më të mirë mbi gjendjen e autoritetit të audituar dhe është qasje më reale.	I ZBATUAR	Plani Strategjik per vitet 2025-2027 i dt. 30.12.2024 me nr 01-030/01-61730,		Te vazhdohet me pune
34	**Menaxhimi i pronës komunale**	Mungesa e monitorimit të duhur të pronave komunale të lëshuara në shfrytëzim	Të formohet një komision për monitorimin e pronave komunale të lëshuara në shfrytëzim	Kryetari i Komunës	2024-2026	Kryetari i Komunës ka krijuar komision për vlerësimin e pronave dhe është funsional.	E realizuar	Zyra e kryetarit me kohë bën caktimin e komisioneve për monitorimin e pronave komunale të lëshuara në shfrytëzim, si dhe zyrtarë komunal janë në përcjellje të kryerjes së obligimeve nga ana e operatorëve që kanë pronat komunale në shfrytëzim		
35	**Prokurimi Publik**	Mungesa e transparencës dhe mbikëqyrja e pa mjaftueshme e prokurimit publik	Identifikimi i nevojave për trajnime për zyrtaret që përfshihen në procedurat e prokurimit publik.	Njësia e prokurimit, NjBNj	2024-2026	Është bërë certifikimi I 2 zyrtarve për Prokurim të avancuar,	I Realizuar	Gjate vitit 2024 jane certifikuar 2 zyratre ne prokurim te avancuar,ndersa ne vitin 2025 eshte certifikuar me certifikat themelore	Numri i limituar I zyrtareve per trajnim nga KRPP	Te rritet numri I zyrtareve per trajnim,
36		Mungesa e stafit te kualifikuar për menaxhimin e kontratave	Caktimi i stafit profesional, të certifikuar dhe ofrimi i trajnimeve për menaxhim të kontratave	Drejtoria e Administratës, NjBNj	2024-2026	Autoriteti Gjithmone ka parasysh qe te caktohen menaxher nga fusha e cila mund te kete njohuri ne lidhje me natyren e kontrates	I Realizuar	Gjate vitit 2025 jane cerrifikuar 35 zyrtare ne trajnimin e organizuar nga IKAP me titullin Menaxhimi i Kontratave	Mungesa e njohurive të kontratave ligjore; Komuniki I dobët me palët e përfshira:Mungesa e përvojes në negocimin e kushteve;	Krijimi I nje strukture të qartë të menaxhimit të kontratav; Mbeshtetja nga ekspertet e jashtëmTrajnimi dhe zhvillimi I aftësive

37		Përgatitja jo efikase e specifikave teknike të projekteve	Rritja e kapaciteteve për përgatitjen e specifikimeve të tenderit. Hartimi i projekteve detale.	Të gjitha drejtoritë dhe Zyra e Prokurimit	2024-2026	Zyra e Prokurimit ka kontraktuar kontrate korniz per hartimin e specifikave te projekteve	Aprovuar	Hartimi i projekteve per nevoja komunes Projekt tre vjeqar me numer te kontrates 611-23-6859-2-1-1/C682	Mungesa e përkufizimeve të qarta ;Ndryshimi I kerkesave gjatë projektimit; Komunikimi I dobet,;Mungesa e burimeve dhe afetsive teknike	Përdorimi I standarteve dhe praktiave më të mira; Komunikimi I vazhdushëm me palët e interesit; Auditimi dhe rishikimet teknike; Trajnimi dhe zhvillimi I ekipeve
38	Urbanizmi dhe Planifikimi Hapësinor dhe Inspektorati	Mangësitë në rregullativën e brendshme në fushën e planifikimit urban dhe rural.	Të miratohet rregulloret e brendshme komunale duke përcaktuar kriteret e qarta që adresojnë rreziqet kryesore në procesin e planifikimit urban dhe rural.	Drejtoria për Planifikim Urban në bashkërendim me drejtoritë sektoriale brenda komunës.	Implementohet brenda viteve 2024/2026	Draftimi i Projekt-Rregullores për Bonuset e Zonimit	Në proces	Webfaqe e komunës: https://kk.rks-gov.net/gllogoc/category/projektet/planet-zhvillimore/?page=2023	Caktimi i kritereve dhe marrja e pëlqimit nga ministritë përkatëse.	Të jetë në harmoni me ligjet dhe UA në fuqi.
39		Mungesa e njohurive të mjaftueshme profesionale në zbatimin dhe mbikëqyrjen e dokumenteve të planifikimit hapësinor.	Të organizohen trajnime profesionale në fushën e zbatimit dhe mbikëqyrjes së dokumenteve të planifikimit hapësinor.	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, Njësia e Burimeve Njerëzore.	2024-2026	Punëtoritë Rajonale mbi Vlerësimin e Nevojave për Kapacitete Drejt Planit 5-Vjeçar të Zhvillimit të Kapaciteteve në Planifikimin Hapësinor	Realizuar	Punëtoritë Rajonale mbi Vlerësimin e Nevojave për Kapacitete drejt Planit 5-Vjeçar të Zhvillimit të Kapaciteteve në Sektorin e Planifikimit Hapësinor. Data: 25.11.2025	Të rritet bashkpunimi ndërmjet nivelit lokal dhe atij qendror.	Zyrtarët të jenë të informuar dhe të marrin pjesë në trajnime të kësaj fushe të organizuara nga niveli qendror
40		Numër i pamjaftueshëm i inspektorëve.	Të planifikohet rekrutimi i stafit të mjaftueshëm të inspektorëve.	Drejtoria e Inspekcionit/Njësia e Burimeve Njerëzore.	2024-2026	Kompletimi me staf të Planifikuar	Realizuar	Të gjitha pozitat e nevojshme për stafin e Drejtorisë së Inspeksionit janë plotësuar		
41		Mungesë e stafit adekuat për kontrollimin e ndërtimeve.	Të sigurohet personel adekuat profesional kontrollimin e ndërtimeve.	Drejtoria e Inspekcionit.	2024-2026	Kompletimi me staf të Planifikuar	Realizuar	Drejtoria e Inspektoratit ka 2 Inspektor të ndërtimeve	Vështirësi në kontrollimin e tërë territorit të komunës	
42		Mungesa e stafit profesional në fushat përkatëse.	Lejimi i vendeve të reja të punës sipas kërkesave të NJK për mbulimin e të gjitha fushave inspektuese që bien nën domenin e DI.	Njësia e Burimeve Njerëzore	2024-2026	Aktivitet të realizuara në vitin paraprak	Realizuar			

43	Rekrutimi, Ofrimi i Shërbimeve në Shëndetin Publik	Mos funksionimi i WEB aplikacionit të digjitalizimit në te gjitha institucionet shëndetësore,	Pajisja me kartela shëndetësore, ndarja zonale dhe lista e pacientëve. Aprovimi i Rregullores së brendshme për sistematizimin e vendeve të punës.	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe KPSH	TM4 2024	Është raportuar në periudhat paraprake				
44		Mungesa e Edukimit dhe Promovimit shëndetësorë në komunitet	Hartimi i programeve lidhur me edukimin dhe promovimin shëndetësorë në komunitet,	DSHMS/ KPSH	2024-2026	Programin për nëna dhe fëmijë deri në moshën 3 vjeç (vizita në teren) si dhe Këshillimorja për sëmundjet kronike jo transmisive	Realizuar	Mbahen aktivietet dhe ligjerata edukuese në komunitet sipas Kalendarit të Promocionit shëndetësorë	Pjesëmarrja e vogël e palëve të interesit dhe mungesa e motivimit për pjesëmarrje sidomos ne viset rurale	
45		Hapësira dhe infrastruktura shëndetësore (pjerrinat, ngrohjet qendrore,	Planifikimi i buxhetit dhe hartimi me kohë i projekteve, investimeve	DSHMS	TM3 2024	Është raportuar në periudhat paraprake				
46		Mungesa e mjekëve familjarë dhe stomatologëve	Implementimi i U.A 04/2020 (1 mjek dhe 2 infermierë në 2000 banorë si dhe një stomatolog në 1000 banorë.	DSHMS/QKMF	2024-2026	Plotësimi i Vendeve të punes me shpallje te konkurseve te vazhdueshme	70%	Konkursi I fundit RN 00018010 , portali shtetëror: https://konkursi.rks-gov.net dhe faqja zyrtare e komunes se Drenasit https://kk.rks-gov.net/gllogoc/.	Lëvizjet e mjekeve ne specializime dhe marrja e specializimeve jo adekuate per KPSH si dhe hapësirat jo adekuate për paisjet stomatologjike	

47	**Rekrutimi i Stafit dhe Mirëmbajtja në Arsimin Publik**	Rënia e vazhdueshme e numrit të nxënësve.	DKA nuk do të shpallë konkurse të reja, fillimisht, do të sistemohen mësimdhënës që mbesin pa normë si pasojë e rënies së numrit të nxënësve.	DKA dhe Shkollat	2024-2026	Eshtë paraparë lista pritëse më Rregullores (QRK) nr:19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IAAP) të arsimit parauniversitar,Udhëzimit Administrativ të MASHTI, nr. 05/2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm	Realizuar	Gjatë vitit 2025 janë nxjerrë disa aktvendime për plotëimin e normave të mësimdhënesve si dhe vendimi të transferimit të mësimdhënësve për plotësim të normave.		Të vazhdohet me plotësime të normave me qëllim të plotësimit të masës së propozuar
48		Pamundësia e planifikimit adekuat për numrin të lehonave dhe pushimeve mjekësore.	Marrja e masave për zëvendësimet adekuate nga stafi ekzistues të cilët kanë mungesë të normave.	DKA dhe Shkollat	2024-2026	Në vitin shkollor 2023/2024 por edhe me fillimin e vitit shkollor jemi duke i plotësuar normat e orëve me staf ekzistues	Në proces			